REPUBLIKA E KOSOVES AGJENCIA E SHERBIMEVE TE NAVIGACIONIT AJROR
REPUBLIKA KOSOVA AGENCIJA ZA VAZDUŠNO NAVIGACIJSKE USLUGE
REPUBLIC OF KOSOVA AIR NAVIGATION SERVICES AGENCY
ZYRA E ARKIVES
KANCELARIJA ARHIVA
ARCHIVES OFFICE
Nr. faq. 28 Data 24.07.2017
Br. str. Datum
Pg. no. Date
Nr. prot. 0323
Br. prot.
Prot. no.
LIPJAN, RKS

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE
DATE PRANUAR/DOREZUAR: 29. 06. 2017
DATUM PRIMLJEN/DOSTAVLJEN:
DATE RECEIVED/SUBMITTED:

Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit	Shif.klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr.i faqeve Br. Stranica No. Pages
24	24.23	806	2

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelaria Revizije
National Audit Office

Për:	Kuvendin e Republikës së Kosovës Bahri Nuredini, Drejtor i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Kopje:	Kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit për Buxhet dhe Financa Kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Nga:	Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm, Republika e Kosovës
SUBJEKTI:	Raporti i auditimit për Raportin Vjetor Financiar të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror për vitin 2016.

Nr. Zyrës: **No. de bureau:**	**Ext:** **Poste:**	**Data:** **29.06.2017**

Data	**Zyra e Pranimit**	**Komentet/Veprimet**	**Inicialet**	*Afati*
		Bashkangjitur mund të gjeni Raportin e auditimit për Raportin Vjetor Financiar të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror për vitin 2016. Brenda 30 ditësh nga pranimi i këtij Raporti, të na dorëzoni një plan që përfshin veprimet që do të ndërmerren për adresimin e rekomandimeve të dhëna në këtë Raport.		

REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA
NACIONALNA KAN
Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Za:	Skupštinu Republike Kosova Bahri Nuredini, Direktor Agencije za Vazdušno Navigacijske Usluge
Kopija:	Predsedavajućem i članovima Komisije za Budžet i Finansije Predsedavajućem i članovima Komisije za Nadzor Javnih Finansija
Od:	Besnik Osmani, Generalni Revizor, Republika Kosova
PREDMET:	Izveštaj revizije o godišnjem finansijskom izveštaju Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge za 2016 godinu

Br. kancelarije:	**Ext:**	**Datum:** **29.06.2017**

Datum	**Prijemna kancelarija**	**Komentari/Akcije**	**Inicijali**	*Rok*
		U prilogu možete naći Izveštaj revizije o godišnjem finansijskom izveštaju Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge za 2016 godinu. Da nam u roku od 30 dana nakon prijema ovog Izveštaja, dostavite plan koji uključuje akcije koje će se preduzeti za adresiranje preporuka koje su date u ovom Izveštaju.		

REPUBLIKA E KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE
Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No.
Nr. i faqeve / Br. Stranica / No. Pages
Klasifik. / Klasif. Kod / Class. Code

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

Nr. i Dokumentit: 24.23.1-2016-08

RAPORTI I AUDITIMIT

PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR

TË AGJENCISË SË SHËRBIMEVE TË NAVIGACIONIT AJROR

PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016

Prishtinë, qershor 2017

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinioni i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Ilir Abazi - Udhëheqës i ekipit të auditimit, me anëtarët e ekipit Mirlinda Beqiri dhe Hysen Boqolli, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit - Bujar Sejdiu.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e Përgjithshëme 4

1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm 6

2 Qeverisja 10

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli 16

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit 26

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA 27

Shtojca III: Komentet e AShNA-së për të gjeturat e raportit të auditimit 30

Përmbledhje e Përgjithshëme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetor të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit[1], të datës 27/11/2016.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën 1):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror.

Opinioni i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes.

Pasqyrat Financiare Vjetore *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se buxheti final për paga e mëditje është nënvlerësuar për 41,000€, burimet e fondeve të shpenzuara janë nënvlerësuar për 23,000€ dhe vlera e pasurisë nuk është shpalosur drejtë. Për më gjerësisht shih Pjesën 1.1 të këtij Raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Dëshirojmë të falënderojmë Drejtorin e Përgjithshëm dhe ekipin e tij për bashkëpunim gjatë tërë procesit të auditimit.

[1] Termi "Plani i Jashtëm i Auditimit" është zëvendësim i termit "Memorandumi i Planifikimit të Auditimit "

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore

Theksimi i çështjes në opinionin e auditimit pasqyron dobësitë në kontrolle për ta konfirmuar prezantimin e drejtë të buxhetit, shpenzimeve, si dhe vlerësimin e pasurisë	Drejtori i Përgjithshëm duhet t'i analizojë arsyet për theksimin e çështjes në 2016 dhe t'i identifikojë veprimet që kërkohen për të mundësuar një prezantim të drejtë dhe të vërtetë të pasqyrave financiare në 2017 (shih nënkapitullin 1.1)
Procesi i përgatitjes së PFV-ve është menaxhuar dobët, me disa gabime financiare dhe të shpalosjes. Edhe kërkesat tjera të raportimit jo çdo herë ishin përmbushur	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që procesi i përgatitjes së PFV 2017 përfshinë një rishikim menaxherial formal dhe efektiv dhe deklarata për PFV-të të nënshkruhet vetëm pasi janë zbatuar të gjitha veprimet e nevojshme (shih çështjen 1)
Aranzhimet e qeverisjes që kanë të bëjnë me procesin e vet-vlerësimit dhe menaxhimit të rrezikut nuk është kuptuar sa duhet nga menaxhmenti dhe përgjigja ndaj çështjeve të ngritura nga raporti i auditimit paraprak nuk po adresohen ashtu siç kërkohet për zhvillimin dhe përmirësimin e organizatës	Drejtori i Përgjithshëm duhet ta zbatojë një proces rigoroz për të siguruar që aranzhimet e qeverisjes janë rishikuar në mënyrë kritike për të siguruar se procesi i vet-vlerësimit, menaxhimi i rrezikut dhe rekomandimet e vitit paraprak adresohen në mënyrë aktive ku çështjet/progreset kyçe i raportohen menaxhmentit në baza mujore (shih çështjet 2 - 6)
Ekzistojnë dobësi në disa sisteme të rëndësishme financiare dhe të kontrollit duke përfshirë pranimet dhe shpenzimet, menaxhimin e pasurisë, implementimin e kontratave dhe administrimin e obligimeve	Drejtori i Përgjithshëm duhet ta aplikojë një vlerësim të detajuar të procesit të menaxhimit dhe regjistrimit të pasurisë dhe fushave tjera brengosëse të theksuara në këtë raport, për t'i identifikuar arsyet për paraqitjen e dobësive si dhe veprimet e nevojshme për t'i adresuar ato (shih çështjet 7 - 12)

Përgjigja e Drejtorit të Përgjithshëm

Drejtori i Përgjithshëm ka marrë në konsideratë të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit. Komentet e Drejtorit të Përgjithshëm për çështjet për të cilat nuk jemi pajtuar janë dhënë në detaje në Shtojcën III.

1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.1 Opinioni i auditimit

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Kemi audituar PFV-të e Agjencisë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (AShNA) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion

Kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

- Në raportin e pranimit dhe pagesave në para të gatshme, burimet e fondeve janë nënvlerësuar për 23,000€, ndërsa te dalja e parasë së gatshme shpenzimet për mallra dhe shërbime janë mbivlerësuar për afër 1,000€;

- Buxheti final për paga e mëditje në tabelën e ekzekutimit të buxhetit është nënvlerësuar për 41,000€; dhe

- Pasuria kapitale e shpalosur në PVF ishte 148,705€, që përfshinë vetëm pagesat e vitit 2016 për investimet kapitale, duke mos përfshirë edhe vlerën e pasurisë në vitet paraprake. Në pasqyrat financiare të vitit 2015 pasuria kapitale ishte në vlerë neto 9,490,327€. Gjithashtu në PFV nuk ishte prezantuar vlera e pasurisë jokapitale dhe stoqeve.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të

Drejtori i Përgjithshëm i AShNA-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrolle të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime). Drejtori është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të AShNA-së.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të

auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Agjencia e Shërbimet të Navigacionit Ajror, është themeluar në janar të vitit 2016, në bazë të Ligjit Nr. 04/L-250 për Agjencinë e Shërbimet të Navigacionit Ajror. Para vitit 2016 AShNA ka funksionuar nën statusin e kompanisë publike me emërtimin Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës – Kontrolli Ajror "Adem Jashari", e që me këtë status ka funksionuar që nga viti 2011, përkatësisht që nga koncesionimi i shërbimeve terminale të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës. Me këtë rast është ndarë Kontrolli i Trafikut Ajror nga njëra anë dhe Shërbimet Terminale nga ana tjetër, ku deri në këtë kohë kanë funksionuar si një ndërmarrje publike me emrin Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari". SH.A.

AShNA funksionon si organizatë e pavarur buxhetore dhe duhet të veprojë në pajtim me politikat, legjislacionin dhe rregullat e administratës publike. Deri në vitin 2015 për raportimin vjetor financiar janë aplikuar Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar me bazë akruale të kontabilitetit. Me kalimin në organizatë buxhetore AShNA duhet të aplikojë Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik me bazë të kontabilitetit në para të gatshme/cash.

Po ashtu AShNA kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga OB;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.02/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.03/2011;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.06/2011;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK); dhe
- Planin e prokurimit dhe raportin e kontratave të nënshkruara publike, etj.

Çështjet e ngritura në Memorandumin e Auditimit, të datës 15/12/2016, në lidhje me kornizën raportuese nuk ishin adresuar plotësisht. Në draft PFV ishin të nevojshme disa korrigjime financiare dhe kemi dhënë disa sugjerime për të përmirësuar cilësinë e tyre. Në kontekst të PVF finale, përpos çështjeve të prezantuara në theksimin e çështjes te opinioni i auditimit, ne kemi identifikuar edhe disa papajtueshmëri tjera si:

- Në shënimet shpjeguese, shënimi 2, 3, 4 dhe 6, shpenzimet janë prezantuar gabimisht si të realizuara nga fondi i të hyrave vetanake e jo nga të hyrat e dedikuara, ndërsa buxheti final sipas llojit të shpenzimeve për paga e mëditje dhe shpenzime komunale nuk është shpalosur;
- Detyrimet kontingjente nuk janë shpalosur, ndërsa te obligimet e papaguara mungojnë informata për afatin e pagesës së faturave; dhe
- Informatat rreth avanceve të pambyllura nuk janë të plota.

Të gjeturat nxjerrin në pah mungesën e rishikimit kritik të PVF-ve nga menaxhmenti, i cili është i nevojshëm për të konfirmuar saktësinë dhe plotësinë e tyre si dhe për të konfirmuar aplikimin e të gjitha kërkesave të tjera për raportim.

Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave mund të konsiderohet e saktë.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, kemi identifikuar se:

- Nuk janë bërë harmonizimet me MF/Thesarin për shpenzimet e TM1, TM2 dhe TM3; dhe
- Deri në muajin tetor 2016, nuk është bërë raportimi mujor i obligimeve të papaguara në MF/Thesar.

1.3 Rekomandimet për pjesën e parë të raportit

Për çështjet e sipërpërmendura me lartë ne japim rekomandimet si në vijim:

Rekomandimi 1 Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe pragmatike për t'i hequr gabimet financiare në PVF dhe për të siguruar një raportim të saktë të pasurive kapitale; dhe

Rekomandimi 2 Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2017 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë përfshirë edhe kërkesat tjera për raportim të jashtëm. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitin e mëparshëm.

2 Qeverisja

Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për AShNA-në që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, pyetësori i vet-vlerësimit siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuara përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Me gjithë angazhimet e menaxhmentit për të krijuar një mjedis të përshtatshëm të kontrollit dhe qeverisjes, ende mbesin një numër fushash ku nevojiten zhvillime të rëndësishme. Sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit nuk ishte mjaftueshëm efektiv për të parandaluar dobësitë e evidentuara në këtë raport. Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes, veçanërisht në lidhje me procesin e vet-vlerësimit, menaxhimin e rrezikut dhe raportimin e brendshëm menaxherial. Auditimi i Brendshëm vetëm pjesërisht ka mbështetur menaxhmentin në ofrimin e sigurisë në funksionimin e kontrolleve të brendshme. Aranzhimet tjera të cilat do ta mbështesnin zhvillimin e qeverisjes, si përgjigjja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit duhet të zhvillohen tutje. Menaxhmenti nuk ka dëshmuar proces të mirëfilltë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve tjera të monitorimit.

Në aspektin e pajtueshmërisë më legjislacionin, auditimi ynë ka shpalosë ekzistencën e disa dobësive të cilat përfshijnë blerjet përmes prokurimit dhe menaxhimin e kontratave, kjo si rezultat i mos zbatimit të rregulloreve të prokurimit dhe mbikëqyrjes së pamjaftueshme nga menaxhmenti. Operimi i një sistemi adekuat për menaxhimin e pasurisë dhe obligimeve financiare ende nuk është vendosur.

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Deri në vitin 2015, PVF-të e AShNA-së janë audituar nga firma private të pavarura të auditimit. Në raportin e auditimit të vitit 2015, janë ngritur çështje në fushën e financave, menaxhimit të pasurisë dhe menaxhimit të obligimeve.

Çështja 3 – Mungesa e planit të veprimit – Prioritet i lartë

E gjetura	AShNA nuk ka përgatitur ndonjë plan veprimi për mënyrën e adresimit të çështjeve të ngritura në raportin e auditimit të vitit 2015 të kryer nga auditorët e jashtëm të pavarur. Kjo pasqyron mungesën e fokusit nga menaxhmenti për të siguruar që dobësitë ekzistuese dhe pengesat potenciale adresohen me kohë. Një qasje e tillë është e nevojshme për të menaxhuar përmirësim të vazhdueshëm në të gjithë organizatën.
Rreziku	Përmirësimet e kërkuara të proceseve operacionale dhe të tjera mund të mos zbatohen duke rezultuar me jo efikasitet të vazhdueshëm organizativ dhe vlerë të dobët për para në praktikat e prokurimit.
Rekomandimi 3	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë përgatitjen e një plani të veprimit, i cili i përcakton afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga auditimi i jashtëm, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.

2.2 Pyetësori i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së

MF ka hartuar një pyetësor të detajuar të vet-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vet-vlerësimit të MFK-së të dorëzuara në MF, duke vlerësuar nga një pyetje kyçe në secilën komponentë të pyetësorit. Ne kemi përmbledhur të gjeturat tona për AShNA më poshtë dhe përmbledhja e punës sonë në të gjitha auditimet do të konsolidohet në Raportin tonë Vjetor të Auditimit. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vet-vlerësimit por do të pasqyrojë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për të mbështetur përpjekjet e MF-së në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Çështja 4 – Pyetësori i vet-vlerësimit dhe menaxhimi i rrezikut – Prioritet i lartë

E gjetura

Si pjesë e auditimit tonë i kemi shqyrtuar çështjet kyçe të aranzhimeve të të qeverisjes dhe kemi gjetur se:

- AShNA nuk ka përmbushur kërkesën e MF-së dhe nuk e ka plotësuar pyetësorin e vet-vlerësimit. Kjo situatë ka ndodhur për shkak të mungesës së qartësisë brenda organizatës që ka të bëjë me rëndësinë e kësaj pyetësori dhe me atë se kush është zyrtari përgjegjës që i përdorë këto mekanizma për t'i mbështetur përmirësimet operative. Procesi i tranzicionit po ashtu ka ndikuar në mosplotësimin e këtij pyetësori; dhe
- Procedurat e MFK-së përcaktojnë që çdo organizatë duhet të vendos një proces efektiv për menaxhimin e rreziqeve financiare dhe operative. Ndonëse është vendosur menaxhimi i rrezikut lidhur me operacionet teknike, AShNA nuk ka zhvilluar ndonjë proces formal për menaxhim të rrezikut sipas kërkesave të MFK-së. Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së alokimit të përgjegjësisë te stafi lidhur me menaxhimin e rrezikut.

Rreziku

Aranzhimet e dobëta të qeverisjes ndikojnë në dobësimin e proceseve strategjike dhe operative dhe e zvogëlojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët përmes aktiviteteve joefikase dhe joefektive. Mungesa e vet-vlerësimit pamundëson identifikimin e dobësive në kontrollin e brendshëm dhe veprimeve efektive për adresimin e tyre. Mungesa e një procesi formal për menaxhim të rrezikut redukton mundësinë e menaxhmentit për të parandaluar dhe/apo kontrolluar rreziqet lidhur me arritjen e objektivave.

Rekomandimi 4

Drejtori i Përgjithshëm duhet t'i analizojë shkaqet e mungesës së aranzhimeve të qeverisjes lidhur me pyetësorin e vet-vlerësimit dhe menaxhimin e rreziqeve. Për pyetësorin e vet-vlerësimit duhet të aplikohet një mekanizëm për ta konfirmuar saktësinë e tij si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës. Drejtori po ashtu duhet të sigurojë që deri më 1 tetor 2017 është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut dhe të sigurojë raportim dhe monitorim sistematik për zbatimin e kërkesave të këtij procesi.

2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit AShNA operon dhe sfidat me të cilat përballet.

2.3.1 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Menaxhmenti duhet të zbatojë një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare dhe operative funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj sfidave operative të identifikuara. Menaxhmenti ka vendosur strukturën organizative si dhe linjat e komunikimit dhe informimit përmes raportimeve për aktivitetet operacionale dhe financiare të organizatës.

Çështja 5 – Raportimi i brendshëm menaxherial – Prioriteti i mesëm

E gjetura AShNA ka vendosur një strukturë organizative dhe menaxhmenti njoftohet kohë pas kohe rreth aktiviteteve operacionale dhe financiare të organizatës. Edhe pse procesi i raportimit të brendshëm tek menaxhmenti është funksional, në disa raste cilësia e raportimit formal nuk ofron një bazë adekuate për të ngritur efektivitetin e menaxhimit financiar dhe kontrolleve në përgjithësi.

Rreziku Cilësia jo e duhur në disa raportime të brendshme mund ta reduktojë efektivitetin e menaxhimit brenda organizatës. Kjo rezulton me dobësi operacionale, organizative dhe financiare si dhe në reduktimin e mundësisë që menaxhmenti të reagojë me kohë ndaj sfidave financiare dhe/apo operative.

Rekomandimi 5 Drejtori i Përgjithshëm duhet ta rishikojë formatin aktual të raportimeve menaxheriale dhe të siguroj përmirësimet e nevojshme dhe të përshtatshme të raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Raportimet cilësore menaxheriale janë të domosdoshme për të mbështetur menaxhimin efektiv të veprimtarisë së organizatës.

2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

AShNA ka Njësinë e Auditimit të Brendshëm (NjAB) që funksionon vetëm me një auditor. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe operative, dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i raporteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruara nga një Komitet i Auditimit efektiv.

Fillimisht me planin vjetor të auditimit ishin planifikuar dhjetë (10) auditime, përfshirë auditimin e buxhetit dhe shpenzimeve, të hyrat, menaxhimin e personelit, prokurimin etj. Deri në fund të muajit gusht 2016 vetëm një auditim kishte përfunduar. Në fund të muajit gusht plani vjetor i auditimit të brendshëm është ndryshuar dhe aprovuar nga menaxhmenti. Plani i rishikuar vjetor parashihte gjashtë (6) auditime, ndërsa deri në fund të vitit ishin realizuar gjithsej katër (4) auditime: auditimi i të hyrave, menaxhimi i automjeteve zyrtare, Plani i prokurimit dhe menaxhimi i kontratave si dhe procedurat e prokurimit (këto dy auditime ishin fuzionuar në një raport të përbashkët). Po ashtu ishte përgatitur një raport rreth implementimit të rekomandimeve të auditimit të vitit 2015 për menaxhimin e teknologjisë informative.

Çështja 6 – Dobësitë në sistemin e auditimit të brendshëm – Prioriteti i lartë

E gjetura

Ekzistojnë disa çështje në lidhje me sistemin e auditimit të brendshëm:

- Vetëm një numër i kufizuar i auditimeve të planifikuara ishte realizuar gjatë vitit 2016. Gjatë periudhës janar-gusht 2016 ishte përfunduar vetëm një (1) nga dhjetë (10) auditimet e planifikuara, ndërsa deri në fund të vitit ishin realizuar tri (3) auditime; dhe
- Auditimet e përfunduara nuk kishin mbuluar fushat me rrezik si buxheti dhe shpenzimet, menaxhimi i personelit dhe menaxhimi i pasurisë; dhe
- AShNA ende nuk e ka themeluar Komitetin e Auditimit (KA). Në statutin e NjAB-së është planifikuar që komiteti i auditimit të themelohet në fillim të vitit 2018.

Këto rezultate pasqyrojnë mungesën gatishmërisë së menaxhmentit në njohjen dhe maksimizimin e përfitimit nga auditimi i brendshëm për të kërkuar siguri për funksionimin efektiv të kontrolleve të brendshme.

Rreziku

Një program jo i plotë i auditimit i cili nuk përfshin fushat me rrezik ndikon në mos identifikimin dhe mos adresimin me kohë të dobësive në kontrolle duke rezultuar në jo efikasitet operativ dhe humbje të mundshme financiare. Mungesa e KA-së redukton rolin e NjAB në përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Rekomandimi 6 Për të arritur përfitimin maksimal nga aktiviteti auditimit të brendshëm, Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë themelimin e KA-së. Plani vjetor i auditimit duhet të jetë bazuar në rrezik dhe të zbatohet nga NjAB. KA duhet të rishikojë në mënyrë kritike planet dhe rezultatet e auditimit të brendshëm. Gjithashtu duhet të rishikojë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit të brendshëm.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë për MFK-në jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin 2, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Nga viti 2016 AShNA funksionon si organizatë buxhetore që administrohet në mënyrë të pavarur dhe në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Kosovës. Menaxhmenti i AShNA-së e kupton rëndësinë e kontrolleve të forta mbi shpenzimet dhe të hyrat dhe nevojën e kontrolleve më të shumta. Auditimi ynë ka nxjerrë në pah ekzistencën e disa dobësive të pajtueshmërisë veçanërisht me menaxhimin e kontratave dhe obligimeve, prokurimit publik, si dhe në menaxhimin e pasurisë. Kjo ka ndodhur si rezultat i mos zbatimit të rregulloreve dhe mungesës së mbikëqyrjes së duhur nga menaxhmenti, nga i cili kërkohet që të sigurojë përmbushjen e të gjitha obligimeve statutore.

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm. Menaxhimi financiar dhe kontrolli efektiv kërkon procese të rishikimit dhe udhëzues përcjellës të cilët sigurojnë zbatimin e plotë të ligjeve, rregulloreve të brendshme dhe proceseve të tjera të kontrollit. Konkluzionet tona bazohen mbi vlerësimin e dosjeve të audituara dhe menaxhmentit i janë ofruar detaje të plota rreth kësaj.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar të hyrat e realizuara, burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Pranimet
Të hyrat e dedikuara[2]	2,810,000	2,810,000	2,705,866
Totali	**2,810,000**	**2,810,000**	**2,705,866**

[2] Të hyrat e dedikuara – janë paratë publike të cilat janë përfituar nga burimet e posaçme të të ardhurave dhe kërkohet me ligj që t`i ndahen një Agjencie të Pavarur.

AShNA financohet tërësisht nga të hyrat e dedikuara dhe të deponuara në Buxhetin e Kosovës. Të hyrat e dedikuara përdoren si burim financimi me prioritet të parë për pagesën e shpenzimeve, para se të ndahen dhe përdoren burimet tjera të financimit.

Tabela 2. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final[3]	2016 Realizimi
Burimet e Fondeve:	2,810,000	**3,010,000**	**2,928,967**
Granti i Qeverisë -Buxheti	-	200,000	200,000
Të hyrat e dedikuara	2,810,000	2,810,000	2,728,967

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 200,000€. Kjo rritje është rezultat i vendimit të Qeverisë për mbulimin e deficitit buxhetor për kategorinë e pagave dhe mëditjeve.

Në vitin 2016, AShNA ka përdorur 97% të buxhetit final ose 2,928,967€ që reflekton nivel të kënaqshëm të performancës buxhetore.

Tabela 3. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	**2,810,000**	**3,010,000**	**2,928,967**
Pagat dhe Mëditjet	2,040,973	2,240,973	2,200,358
Mallrat dhe Shërbimet	522,527	522,527	482,290
Shërbimet komunale	46,500	46,500	46,319
Investimet Kapitale	200,000	200,000	200,000

[3] Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga MF.

3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara në 2016 ishin në vlerë 2,705,866. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga ofrimi i shërbimeve të navigimit ajror. Të hyrat e inkasuara konsiderohen të hyra të dedikuara, e të cilat depozitohen në Fondin e Kosovës dhe shfrytëzohen nga AShNA. Të hyrat janë regjistruar në SIMFK në kode përkatëse ekonomike si dhe janë bërë harmonizime të rregullta mujore me MF/Thesar.

Çështja 7 – Dobësi në menaxhimin e të hyrave - Prioritet i mesëm

E gjetura

Ndonëse AShNA ka vendosur kontrolle mbi të hyrat, auditimi ynë ka identifikuar dobësitë në vijim:

- Vonesa në regjistrimin e të hyrave në SIMFK dhe vonesa në arkëtimin e faturave nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës i menaxhuar nga koncesionari Limak & Airports de Lyon;
- AShNA faturon në baza mujore për aterimet e fluturakeve në bazë të peshës së tyre prej 5,2€/ton. Fatura përgatitet në bazë të shënimeve që AShNA pranon nga "Limak". Ne kemi gjetur që gjatë gjashtëmujorit të parë 2016 të dhënat e gjeneruara nga departamenti brenda AShNA-së nuk përputheshin me të dhënat e pranuara nga "Limak". Këto mospërputhje ishin adresuar në pjesën e dytë të vitit dhe të dhënat harmonizohen; dhe
- Ndonëse vlera jo-materiale, provizionet për transferet bankare me rastin e inkasimit të të hyrave nuk janë trajtuar dhe kontuar duhet.

Rreziku

Dobësitë e identifikuara reflektojnë kontrolle jo efektive në disa periudha në procesin e faturimit, regjistrimit dhe inkasimit të të hyrave. Kjo rezulton në papajtueshmëri me kërkesat ligjore dhe mund të rezultojë me humbje potenciale financiare.

Rekomandimi 7

Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që është ndërmarrë një shqyrtim i kontrolleve në lidhje me menaxhimin e të hyrave dhe që kontrollet janë ri-dizajnuar sipas nevojës. Proceset e rishikuara duhet të sigurojnë që dallimet mes të të dhënave të Limak-ut dhe AShNA-së janë identifikuar me kohë dhe që procedurat janë efektive për të parandaluar mospërputhjet potenciale.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Në fund të vitit AShNA kishte 150 të punësuar nga 160 sa ishin aprovuar me Ligjin e Buxhetit për vitin 2016. AShNA udhëhiqet nga Drejtori i Përgjithshëm (DP) dhe dy zëvendës-drejtorë, të cilët janë emëruar nga Qeveria në fund të muajit qershor 2016. Me Ligjin 04/L-250 është përcaktuar që kompensimi dhe përfitimet tjera për DP-në dhe zëvendës-drejtorët, si dhe kompetencat, përgjegjësitë, kriteret dhe procedurat për emërimin dhe shkarkimin e zëvendës-drejtorëve bëhen përmes akteve nënligjore të cilat i nxjerr Qeveria. Në fund të vitit 2016, Qeveria ka nxjerr një akt nënligjor për emërimin dhe shkarkimin e zëvendës-drejtorëve, por jo edhe aktin nënligjor për kompensimet dhe përfitimet e DP-së dhe zëvendës-drejtorëve. Po me këtë ligj është përcaktuar që DP me akt nënligjor rregullon funksionimin dhe pozitat e personelit. Në fund të vitit 2016, DP ka aprovuar Rregulloren për Organizimin dhe Funksionimin e Brendshëm të Agjencisë, dhe ndër të tjera, është definuar që menaxhimi i personelit dhe aspektet e punësimit rregullohen me Ligjin për Shërbyesit. Deri në aprovimin e kësaj rregullore, rekrutimi dhe menaxhimi i personelit është trajtuar sipas Ligjit të Punës.

Çështja 8 – Menaxhimi i personelit – Prioritet i mesëm

E gjetura

Testimet e bëra tregojnë se menaxhmenti nuk i ka zbatuar kontrollet ekzistuese në mënyrë efektive për të siguruar pajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret relevante. Testimet tona kanë identifikuar se:

- Nuk ka filluar së zbatuari Sistemi Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNj), përmes së cilës menaxhohen informatat për secilën dosje të personelit;
- Departamenti i Burimeve Njerëzore (DBNj) nuk kishte përgatitur Planin Individual Vjetor të Personelit. Pozitat e lira të punës ende nuk janë plotësuar;
- Kontratat e punës nuk janë azhurnuar gjatë vitit 2016 për t'u harmonizuar me statusin e ri të organizatës por përmbajnë informata që ndërlidhen me organizatën si ndërmarrje publike. Pas aprovimit të rregullorës për sistematizim të vendeve të punës në vitin 2017, kontratat e punës janë shndërruar në Akt Emërime sipas kërkesa të Ligjit për Shërbimin Civil; dhe
- Përvoja e punës së një punonjësi nuk ishte llogaritur drejtë. Përvoje e punës ishte llogaritur edhe koha e punës praktike. Gjithashtu, mungonte vendimi i nxjerre nga DBNj për njohjen e viteve të përvojës për kompensimin mbi përvojën e punës.

Rreziku Dobësitë e identifikuara në fushën e personelit tregojnë se kontrollet e brendshme nuk kanë qenë efektive në të gjitha rastet. Përveç efekteve financiare, dobësitë e identifikuara, si mungesa e planit dhe mos aplikimi i SIMBNj-së vështirëson menaxhimin efektiv të personelit.

